

Banka e Shqipërisë

TENDENCAT NË KREDITIM

TREMUJORI III - 2016

ERJONA SULJOTI, SOFIKA NOTE DHE OLTA MANJANI
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

TETOR 2016

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P E R M B A J T J A

<i>PËRMBLEDHJE</i>	<i>5</i>
<i>1. KREDIA PËR BIZNESE</i>	<i>7</i>
<i>2. KREDIA PËR INDIVIDË</i>	<i>10</i>
<i>3. ÇMIMI I KREDISË DHE KUSHTET E TJERA TË KREDITIMIT</i>	<i>12</i>
<i>4. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT</i>	<i>16</i>

Ky material synon të paraqesë një panoramë të zhvillimeve të fundit të aktivitetit kreditues në vend. Për të përmbushur këtë qëllim, materiali analizon të dhënat monetare për portofolin e kredisë, si dhe kushtet e kreditimit. Gjithashtu, pjesë e këtij materiali është edhe një përmbledhje e zhvillimeve të fundit të aktivitetit kreditues në vendet e Evropës Qendrore Juglindore (EQJL).

Statistikat kryesore të analizuar në material janë:

- të dhënat për aktivitetin kreditues të bankave për sektorin rezident të ekonomisë;
- të dhënat cilësore të marra nga vrojtimi i aktivitetit kreditues;
- statistikën për çmimin e kredisë, si në monedhën vendase ashtu edhe në euro;
- të dhënat monetare për vëllimin e kredisë për vendet e rajonit. Vendet e përfshira në analizë janë: Bullgari (BU), Kroaci (Cr), Rumani (RO), Serbi (Sr), Poloni (Pl), Hungari (Hu), Çeki (CZ), Maqedoni (IRJM).

Materiali mbulon të dhënat e publikuara deri më 12 tetor 2016, të cilat përshijnë informacion për të dhënat monetare dhe financiare për muajin gusht 2016, si dhe të dhënat e vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e tretë të vitit 2016.

PËRMBLEDHJE

Rritja vjetore e kredisë për sektorin privat prej 3%, në muajt korrik-gusht, mbeti pranë niveleve mesatare të tremujorit të dytë. Megjithatë, reduktimi i portofolit krahasuar me muajin qershor tregon se rimëkëmbja e aktivitetit kreditues mbetet e brishtë. Paralelisht, ecuria e kredisë për individët shfaqet me përmirësim të qëndrueshëm. Në tërësi, ritmet e rritjes së kredisë për sektorin privat mbeten pranë niveleve të pritura dhe udhëhiqen nga rritja e shpejtë e kreditimit në lekë. Kreditimi në valutë, duke marrë në konsideratë edhe mbiçmimin e lekut ndaj monedhave kryesore, shfaqet në terren pozitiv, por në nivele të moderuara.

Kredia për biznese ka shënuar një normë mesatare të rritjes vjetore prej 2.4% në muajt korrik-gusht, e ngjashme me atë të shënuar në tremujorin e dytë. Kjo normë është mbështetur nga kreditimi për qëllime likuiditeti, ndërsa kredia për investime ka shfaqur ngadalësim të dukshëm. Ecuria e kredisë për biznese është përcaktuar nga një kërkesë e segmentuar për financim nga bizneset dhe kushte të shtrënguara financimi nga bankat. Shtrëngimin e kushteve në tremujorin e tretë, bankat e kanë reflektuar në forcimin e kërkesave për kolateral.

Rritja vjetore e kredisë për individë, në muajt korrik dhe gusht, është më e lartë se ajo në tremujorin e dytë, duke shënuar 4.6% në muajin gusht. Ecuria e mirë e kredisë për individë ka reflektuar një zgjerim të shpejtë të kredisë për konsum dhe një rritje të qëndrueshme të kredisë për banesa. Zhvillimet pozitive në të dyja portofolet mbështeten, si nga kushtet e kreditimit që vijojnë të lehtësohen, ashtu edhe nga një kërkesë e rritur për kredi. Zgjerimi i kredisë për individë është mbështetur plotësisht nga kredihënja në monedhë vendase, duke kompensuar tkurrjen e tepricës në valutë.

Normat e interesit të kredisë së re në muajt korrik dhe gusht kanë mbetur në nivele të ulëta. Normat e interesit në lekë kanë rënë për bizneset dhe lehtësisht edhe për individët. Ndërkohë, interesat e kredive në euro kanë qenë të qëndrueshme për bizneset dhe kanë shënuar rënie për individët. Krahas normave më të ulëta të interesit, bankat kanë ofruar edhe kushte më të mira joçmim për kreditë të dhëna, me përjashtim të kërkesave për kolateral për bizneset, të cilat janë shtrënguar.


Në muajt korrik dhe gusht, **vendet e rajonit** kanë shfaqur një rritje të kredisë për sektorin privat me ritme më të përmbajtura, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit. Në terma mesatarë vjetorë, stoku i kredisë shënoi rritje prej 4% për të gjithë rajonin. Vrojtimet e aktivitetit kreditues të bankave në vendet e EQJL-së tregojnë se rritja e kreditimit në këtë rajon nxitet nga kërkesa më e lartë

e agjentëve ekonomikë për kredi, si nga bizneset dhe nga individët. Nga ana tjetër, normat vjetore të rritjes së kredisë kushtëzohen nga standardet e shtrënguara të kreditimit. Rajoni i Evropës Qendrore vijon të shënojë norma të qëndrueshme rritjeje, duke mbajtur peshën kryesore të zgjerimit të kredisë për rajonin e EQJL-së. Zhvillimet e kredisë në vendet e Ballkanit tregojnë për ngadalësim të normave të kreditimit.

1. KREDIA PËR BIZNESE¹

Ritmet vjetore të rritjes së kredisë për biznese kanë qenë të ngjashme me ato të tremujorit të dytë, duke treguar për një rimëkëmbje të ngadaltë të këtij segmenti. Në veçanti, reduktimi mujor i këtij portofoli tregon se kjo rimëkëmbje mbetet e brishtë, e kushtëzuar si nga një kërkesë e segmentuar ashtu edhe një ofertë e ngurtë e bankave për të rritur financimin. Kushtet e kreditimit janë shtrënguar në tremujorin e tretë, duke konfirmuar një përjasje të kujdesshme të bankave ndaj financimit të bizneseve. Rrezikun e shtuar të kredisë për biznese, bankat e kanë pasqyruar më së shumti në shtrëngimin e kërkesave për kolateral, ndërkohë që normat e interesit kanë ruajtur përgjithësisht tendencën rënëse. Paralelisht, bankat shprehen për një kërkesë më të lartë për financim nga bizneset se sa në tremujorin e kaluar.

Kredia për biznese në muajt korrik dhe gusht, edhe pse shënoi mesatarisht të njëjtën rritje vjetore me tremujorin e dytë, tregon një ecuri të brishtë të këtij segmenti. Rritja vjetore e këtij portofoli me 2.7% në muajin gusht shfaqet e ngadalësuar, përkundrajt 3.5% që shënonte në muajin qershor². Gjithashtu, zhvillimet mujore tregojnë se kredia për biznese në këta dy muaj u reduktua me 4.2 miliardë lekë, duke kthyer tendencën pozitive të vërejtur në tremujorin e dytë të vitit. Ky reduktim ka qenë i përqendruar në kredinë në valutë dhe




¹ Të dhënat e kredisë për biznese përjashtojnë efektin e kredive të riklasifikuara në zërat jashtë bilancit.

² Në këto norma vjetore, një ndikim të rëndësishëm ka pasur edhe ecuria mbiçmuese e kursit të këmbimit të lekut kundrejt monedhave kryesore. Duke marrë në konsideratë këtë efekt, rritja vjetore e portofolit të kredisë për biznese do të shënonte 3.6% - e ngadalësuar nga normat e arritura në muajin qershor prej 4.8%.

është shfaqur në tkurrjen e kredisë për likuiditete edhe të asaj për investime. Ngadalësimi i dy muajve të verës vlerësohet të jetë ndikuar jo vetëm nga një rikthim i sjelljes të dobët sezonale të kredisë në këta muaj, por edhe nga kushtet e shtrenguara të ofertës për kredi nga bankat.

Gjithashtu, edhe kredia e re e disbursuar në muajt korrik dhe gusht është shfaqur me rënie. Kredia e re, duke përjashtuar overdraftin, është 1% më e ulët se e njëjta periudhë një vit më parë. Ky tregues për dy tremujorët e parë të vitit ishte ndjeshëm më pozitiv, përkatësisht 5.5% dhe 4.4%.

Ngadalësimi i kreditimit të bizneseve është vërejtur si në rënieve të rritjes së kredisë për biznese në lekë ashtu edhe në valutë, të cilat shënuan përkatësisht 4.1% dhe 1.8% përkundrejt rritjes prej 4.8% dhe 2.7% të vërejtur në fund të tremujorit të dytë. Ndërkohë, sipas qëllimit të përdorimit të financimit, ngadalësimi është shkaktuar nga zvogëlimi i normës së rritjes së kredisë për qëllime investimi në 1.6%, ose 2.3 pp më pak se në muajin qershor. Pavarësisht tkurrjes mujore të portofolit të kredisë për likuiditete, norma e rritjes vjetore të saj u përsheptua në 3.7%, ose 0.7 pp më e lartë se në muajin qershor.




Në tremujorin e tretë të vitit, vihet re se është përmirësuar kreditimi për bizneset në sektorin e "Industriës" dhe atë të "Shërbimeve të tjera". Normat vjetore të rritjes së këtyre portofoleve, në muajin gusht, janë përmirësuar në përkatësisht 0.2% dhe 9.1%. Në muajt korrik dhe gusht, teprica e kredisë për sektorin e industrisë ishte 0.8 miliardë lekë më e lartë se në muajin qershor, duke ndryshuar kështu tendencën tkurrëse që ka karakterizuar këtë portofol në pjesën e parë të vitit 2016. Kreditimi për bizneset e ndërtimit dhe ato të sektorit të tregtisë, hotele dhe restaurante, nuk iu është përmbajtur ritmeve të larta të shënuara në tremujorin e dytë të vitit. Normat vjetore të rritjes të kredisë për secilin sektor u ngadalësuan përkatësisht në 0% dhe 2.9%, krahasuar me 3.8% dhe 6.7% të shënuar në muajin qershor. Rigjallërimi i aktivitetit ekonomik në sektorin e ndërtimit mbetet i luhatsëm dhe zgjerimi i financimit për këtë

sektor ndiqet me një kujdes të shtuar nga bankat. Zhvillimet mujore në dy muajt e verës tregojnë reduktim të kredisë për ndërtim dhe asaj për tregti, hotele dhe restorante, me 0.8 dhe 4 miliardë përkatësisht. Kjo e fundit është e ndikuar veçanërisht nga tkurrja e financimit për bizneset e sektorit të tregtisë.

2. KREDIA PËR INDIVIDË³


Në tremujorin e tretë, kredia për individë është rritur me ritme më të larta se në gjashtëmujorin e parë të vitit, duke reflektuar rritjen e kërkesës dhe lehtësimin e mëtejshëm të standardeve. Zgjerimi i këtij portofoli është mbështetur më së shumti nga kredia për konsum, e cila përshpejtoi ritmet e rritjes në 12.3%. Ndërkohë, kreditimi për financimin e blerjeve të banesave ka shfaqur një përmirësim më të ngadaltë të ritmeve vjetore të rritjes, duke shënuar 3.7% në muajin gusht. Vrojtimi i aktivitetit kreditues në tremujorin e tretë tregon se bankat kanë vazhduar të lehtësojnë kushtet e kreditimit, të cilat janë shoqëruar edhe me rritjen e kërkesës për kredi nga individët.

Kredia për individë është rritur me rreth 1.9 miliardë lekë gjatë muajve korrik dhe gusht, duke u mbështetur nga ecuria pozitive e kredisë në lekë. Rritja prej 2 miliardë lekësh e kredisë në monedhën vendase kompensoi tkurrjen e pakët të kredisë për individë në valutë. Në terma vjetorë kredia për individë ka shënuar një tjetër përmirësim të normave të rritjes në 4.6% në muajin gusht. Portofoli i kredisë në lekë shënoi normën më të lartë të rritjes vjetore prej më shumë se një viti, në 11.4%. Ndërkohë, kredia në monedhë të huaj për individë është tkurrur me 2.8%, krahasimisht me një vit më parë. Gjithsesi, ecuria vjetore e portofolit të kredisë në valutë është ndikuar dukshëm nga forcimi i lekut ndaj monedhave të huaja. Rregulluar për këtë efekt, tkurrja vjetore e portofolit të kredisë në valutë për individë do të ishte rreth 1%. Rritja e kredisë për individë për mbiçmimin e lekut ndaj monedhave kryesore, është 5.5% në muajin gusht, normë kjo ndër më të lartat që prej gushtit të vitit 2009.



³ Të dhënat e kredisë për individë përjashtojnë efektin e kredisë të riklasifikuara në zërat jashtë bilancit.

Kreditë e bankave kanë mbështetur më së shumti nevojat e individëve për financimin e konsumit. Zgjerimi i ritmeve të rritjes të kredisë konsumatore në muajin gusht kulmoi me normën vjetore të rritjes prej 12.3%. Zhvillimet pozitive në këtë portofol lidhen si me lehtësimin e mëtejshëm të standardeve për këtë portofol⁴, ashtu edhe nga një kërkesë e shtuar e individëve për financim nga bankat. Ecuria pozitive e konsumit së bashku me përmirësimin e besimit konsumator, dhe ambientimin/ perceptimin e individëve për normat historikisht të ulëta të kredisë bankare duket të ketë nxitur këtë kërkesë. Paralelisht, ky segment i kredisë ka përfituar edhe nga politikat e bankave të orientuara drejt rritjes të kreditimit të këtij segmenti. Këto politika janë vërejtur në lehtësimin e kriterëve për kolateral, zgjatjen e maturitetit, shtimin e sasisë së kredisë, si dhe rritjen e raportit të këstit ndaj të ardhurave.




Gjithashtu, të lehtësuara kanë qenë edhe kushtet për kredinë hipotekare, të cilat janë shoqëruar edhe me rritjen e kërkesës. Rritja vjetore e kredisë për banesa në 3.7% në muajin gusht, është mbështetur nga rritja e kredisë në lekë në këtë segment. Ky portofol po zhvendoset drejt kredisë në lekë. Në muajin gusht, kredia në lekë për banesa përbënte rreth 41% të kredisë hipotekare ose 2 pp më shumë se fundi i vitit 2015. Kjo zhvendosje është mbështetur nga rënia e ndjeshme e interesit të kredisë për banesa në lekë, shumë pranë niveleve të interesit të kredisë hipotekare në euro.

⁴ Sikurse duket edhe nga ofertat e vazhdueshme të bankave për këtë segment.

3. ÇMIMI I KREDISË DHE KUSHTET E TJERA TË KREDITIMIT

Normat e interesit të kredisë, në muajt korrik dhe gusht, kanë mbetur në nivele të ulëta. Normat e interesit në lekë kanë rënë për bizneset dhe lehtësisht edhe për individët. Ndërkohë, interesat e kredive në euro kanë qenë të qëndrueshme për bizneset dhe kanë shënuar rënie për individët. Krahas normave më të ulëta të interesit, bankat kanë ofruar edhe kushte më të mira joçmim për kreditë e dhëna, me përjashtim të kërkesave për kolateral për bizneset, të cilat janë shtrënguar.

Norma e interesit të kredisë në lekë, në muajt korrik dhe gusht, shënoi përkatësisht 7.29% dhe 6.83%⁵, duke mbetur në nivele të ulëta. Sipas maturitetit, rënie kanë pësuar normat e interesit për kreditë afatshkurtra, ndërkohë që ato me maturitet të gjatë janë rritur lehtësisht. Në terma mesatarë, interesi në këta dy muaj është 0.34 pp më i ulët se në tremujorin e dytë të vitit⁶ dhe 0.84 pp më i ulët se një vit më parë. Paralelisht, normat e interesit të kredisë së re në euro shënuan 5.44% dhe 4.72% përkatësisht në muajt korrik dhe gusht, duke mbetur mesatarisht në nivele të ngjashme me mesataren e tremujorit të dytë. Kjo ecuri e interesit të kredisë së re në euro është përcaktuar nga nivele më të larta të interesit në segmentin e kredisë afatshkurtër dhe më të ulëta në atë afatgjatë.




⁵ Norma mesatare e kredisë në lekë në muajin gusht, rezultoi 7.97%, por ajo u ndikua ndjeshëm nga një kredi e veçantë afatshkurtër. Analiza për normat e interesit në lekë në vazhdim i referohet normës mesatare të interesit duke përjashtuar këtë kredi.

⁶ Krahasimi është bërë duke përjashtuar nga llogaritjet edhe një kredi të dhënë në muajin prill për një kompani publike, me normë jotypike interesi.

Norma mesatare e interesit për kredinë e re në lekë për bizneset në muajt korrik dhe gusht është më e ulët se në tremujorin e dytë, me rreth 0.58 pp⁷. Sipas qëllimit të përdorimit, normat e interesit kanë shfaqur rënie për kreditë overdraft dhe kanë vijuar të bien më tej për kreditë për investime në pasuri të paluajtshme. Ndërkohë, ato kanë mbetur thuajse të pandryshuara për kreditë për kapital qarkullues dhe janë rritur për kreditë për blerje pajisjesh. Në një horizont kohor më të gjerë, normat e interesit për kreditë në lekë për biznese janë më të ulëta për të gjitha segmentet. Kështu, norma mesatare e interesit për periudhën janar–gusht 2016 është rreth 0.36 pp më e ulët se në vitin 2015 dhe 0.69 pp më e ulët se në vitin 2014.

Norma mesatare e interesit për kreditë në euro për bizneset, në muajt korrik dhe gusht, mbeti thuajse e pandryshuar nga tremujori i dytë i vitit. Megjithatë, qëndrueshmëria e saj reflekton ecuri të ndryshme të normave të interesit sipas qëllimit të përdorimit. Kështu, normat e interesit të kredive për investime rezultojnë më të ulëta, ndërkohë që ato për financimin e nevojave për likuiditet të bizneseve janë rritur kundrejt tremujorit të mëparshëm. Gjatë vitit 2016, norma mesatare e kredive në euro për biznese është më e ulët se në vitet e mëparshme, me 0.59 pp kundrejt vitit 2015 dhe me 1.54 pp kundrejt vitit 2014. Reduktimi i saj është i pranishëm në të gjitha llojet e financimit në euro për biznese.




Në tremujorin e tretë të vitit, bankat kanë shtrënguar standardet e kreditimit për bizneset e mëdha dhe i kanë mbajtur ato të pandryshuara për bizneset e vogla dhe të mesme. Sipas qëllimit të përdorimit, shtrëngimi ka qenë i pranishëm për të gjitha llojet e financimit. Elementi nëpërmjet të cilit është realizuar shtrëngimi i standardeve ka qenë rritja e kërkesave për kolateral. Ky standard është shtrënguar për të tretin tremujor radhazi, në reflektim edhe

⁷ Sipas të dhënave të publikuara, interesi mesatar i kredisë ka rezultuar më i lartë në muajin gusht, por kjo rritje u diktua nga një kredi overdraft me peshë të madhe, e dhënë nga një nga bankat e sistemit në muajin gusht. Analiza e mëposhtme e përjashton nga llogaritjet këtë kredi.

të vështirësive që kanë hasur bankat në trajtimin/ekzekutimet e kolateraleve të kredive të humbura. Elementët e tjerë joçmim, si maturiteti i kredisë apo madhësia e saj, rezultojnë në kahun lehtësues të standardeve të kreditimit, por në një masë të vogël. Marzhi për kreditë me rrezik të lartë, i cili në tre vitet e mëparshëm ka shërbyer si element i rëndësishëm nëpërmjet të cilit bankat shtrëngonin standardet e kreditimit, nuk ka ndryshuar as gjatë këtij tremujori, si edhe në dy tremujorët e parë të vitit.

Norma mesatare e interesit për kreditë në lekë për individë, në muajt korrik dhe gusht, ka mbetur thuajse e pandryshuar - ajo rezultoi 0.05 pp më e ulët se në tremujorin e dytë të vitit. Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, norma më të ulëta janë regjistruar për kreditë overdraft, kreditë për konsumin e mallrave të qëndrueshme dhe kreditë për pasuri të paluajtshme. Rritje të lehtë ka pësuar norma e interesit për kreditë dhënë individëve për ushtrim aktiviteti, ndërkohë që ajo për kredinë për konsumin e mallrave jo të qëndrueshme ka mbetur në nivelet e mëparshme. Mesatarisht për periudhën janar–gusht 2016, norma e interesit për kreditë në lekë për individë është 1.38 pp më e ulët se në vitin 2015 dhe 2.72 pp më e ulët se në vitin 2014. Reduktimi i normave të interesit në dy vitet e fundit është më i fortë për kreditë për konsum dhe për ato hipotekare, dhe më pak për kreditë *overdraft* dhe për ato për ushtrim aktiviteti.




Individët kanë përfituar edhe nga norma më të ulëta interesi për kreditë në euro. Në muajt korrik dhe gusht, norma mesatare e interesit për këto kredi rezultoi mesatarisht 0.11 pp më e ulët se në tremujorin e dytë të vitit. Rënia e normave të interesit ka qenë e ndjeshme në kreditë overdraft dhe ato konsumatore. Norma e interesit për kreditë hipotekare, të cilat kanë përbërë rreth 60% të kredisë së re në euro për individë, ka mbetur në nivele të ngjashme me ato të tremujorit të dytë. Me rritje shfaqen normat e interesit për kredinë për ushtrim aktiviteti të individëve, por pesha e saj në kredinë e re ka qenë e papërfillshme në këta dy muaj (1.4%). Sikurse edhe për kreditë në lekë, normat e interesit për kreditë në euro gjatë vitit 2016 janë më të ulëta se

në dy vitet e mëparshme, por në një masë më të vogël. Interesi mesatar për tetë muajt e parë të këtij viti rezulton 0.93 pp më i ulët se në vitin 2015 dhe 1.33 pp më i ulët se në vitin 2014.

Diferenca e normave të interesit për kreditë në lekë kundrejt atyre në valutë, në segmentin e individëve, vijon të ngushtohet, veçanërisht pas muajit mars – pas dy uljeve të fundit të normës bazë të interesit. Për periudhën korrik-gusht, kjo diferencë ka rezultuar 2.5 pp, pranë vlerës së tremujorit të dytë. Në terma mesatarë për vitin 2016, ajo është 1.4 pp më e ulët se në vitin 2015 dhe 2.8 pp më e ulët se në vitin 2014. Ngushtimi i diferencës mes lekut dhe euros ka inkurajuar edhe më tepër individët për t’u orientuar drejt monedhës vendase në huamarrje. Kjo diferencë është në nivele minimale (më pak se 0.5 pp) për kreditë hipotekare, të cilat mbartin edhe një rrezik më të lartë të kursit të këmbimit, si rrjedhojë e afatit të gjatë të maturimit që ato kanë.

Bankat vazhdojnë të jenë më pozitive kundrejt kreditimit të individëve. Në tremujorin e tretë të vitit, ato kanë lehtësuar më tej standardet e kreditimit për kreditë konsumatore, ndërkohë që i kanë mbajtur ato të pandryshuara për të dytin tremujor radhazi për kreditë hipotekare. Konkurrenca mes bankave është materializuar në lehtësim të vazhdueshëm të të gjitha standardeve të kreditimit, si ato çmim, ashtu edhe ato joçmim. Në këtë tremujor, ato kanë ngushtuar edhe marzhin e aplikuar për kreditë me rrezik më të lartë se ai tipik për kreditë për individë, i cili, në periudhat e mëparshme, është përdorur për të shtrenguar kredidhënien ndaj individëve.


Grafik 8. Ecuria e kushteve të kreditimit për individët



4. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT


Vendet e rajonit kanë shfaqur një rritje të kredisë për sektorin privat me ritme më të përmbajtura krahasuar me tremujorin e dytë të vitit. Në terma mesatarë vjetorë, stoku i kredisë shënoi rritje prej 4% për të gjithë rajonin. Vrojtimet e aktivitetit kreditues të bankave në vendet e EQJL-së tregojnë se rritja e kreditimit në këtë rajon nxitet nga kërkesa e agjentëve ekonomikë për kredi, si nga bizneset dhe nga individët. Nga ana tjetër, normat vjetore të rritjes së kredisë kushtëzohen nga standardet e shtrënguara të kreditimit. Rajoni i Evropës Qendrore vijon të shënojë norma të qëndrueshme rritjeje, duke mbajtur peshën kryesore të zgjerimit të kredisë për rajonin e EQJL-së. Zhvillimet e kredisë në vendet e Ballkanit tregojnë për ngadalësim të normave të kreditimit.

Kredia për sektorin privat në vendet e rajonit, në muajt korrik dhe gusht, shfaqet me ritme më të përmbajtura krahasuar me tremujorin e dytë të vitit. Stoku i saj shënoi rritje prej 4% në terma mesatarë vjetorë për të gjithë rajonin, duke rezultuar më e moderuar, krahasuar me normën prej 4.9% që shënonte në tremujorin e dytë të vitit. Vrojtimet e aktivitetit kreditues të bankave në vendet e EQJL-së tregojnë se rritja e kreditimit në këtë rajon nxitet nga rritja e kërkesës si nga bizneset dhe nga individët. Në vrojtimin e fundit, bankat janë shprehur se e njëjta tendencë pritet të vijojë edhe në gjysmën e dytë të vitit 2016. Nga ana tjetër, normat e kreditimit kushtëzohen nga standardet e shtrënguara të kreditimit nga kahu i ofertës, duke krijuar kështu dhe një hendek midis kërkesës dhe ofertës për kredi në këto vende.



Në terma rajonalë, ecuria e kredisë mbetet relativisht e segmentuar. Rajoni i Evropës Qendrore vijon të shënojë norma të qëndrueshme rritjeje, duke mbajtur peshën kryesore të zgjerimit të kredisë për EQJL-në. Zhvillimet e kredisë në vendet e Ballkanit tregojnë për ngadalësim të normave të kreditimit, por kjo ecuri rezulton të jetë e lokalizuar, ndikuar nga zhvillime specifike në Rumani⁸. Serbia, Maqedonia e Shqipëria kanë vijuar të rriten me ritme të moderuara, por relativisht të qëndrueshme. Ndërkohë, ecuria e kredisë në vendet e tjera mbetet në territor negativ.


Portofoli i kredisë për biznese në rajonin e Evropës Qendrore ka vijuar të rritet me norma të qëndrueshme, por në ngadalësim në tre muajt e fundit. Nga ana tjetër, rajoni i Ballkanit, pas një përmirësimi të kredisë për biznese në periudhën mars-maj, ka hyrë sërish në territor negativ në muajin qershor, duke mbetur e tillë edhe për muajt korrik-gusht. Kjo ecuri është ndikuar nga disa vende si Rumania, Kroacia dhe Bullgaria, të cilat regjistrojnë tkurrje vjetore në portofolin e kredisë për biznese. Shqipëria renditet mirë për sa i takon zgjerimit të kredisë për biznese, duke shënuar norma të qëndrueshme rritjeje në muajt e fundit.



Standardet e kreditimit të bizneseve për rajonin e EQJL-së, sipas aktivitetit kreditues në këto vende, rezultojnë të lehtësuara në dy tremujorët e parë të vitit. Standardet e përmirësuara të kreditimit kanë ndikuar dhe ecurinë e kërkesës në rajon, e cila, për të njëjtën periudhë, shfaqet gjithashtu me rritje. Në linjë me pritjet për lehtësimin e standardeve të këtij segmenti edhe në tremujorin e ardhshëm, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga bizneset.

⁸ Shuarja e efektit statistikor që nga muaji qershor i bazës së ulët krahasuese.


Grafik 11. Ecuria e kushteve të kreditimit dhe kërkesës së bizneseve në Shqipëri dhe në vendet e rajonit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zgjerimi i kredisë në vendet e rajonit ka vijuar të mbështetet kryesisht nga performanca e mirë në segmentin e individëve, e cila karakterizohet nga një ecuri më e njëtrajtshme në terma rajonalë. Pavarësisht ngadalësimit të normave rritëse në muajt e fundit, rajoni i Evropës Qendrore dhe rajoni i Ballkanit kanë shënuar norma vjetore prej 5.3% dhe 5.2%, përkatësisht në periudhën korrik-gusht. Kredia për individë mbetet në territor negativ në rastin e Hungarisë, pavarësisht zbutjes së normave rënëse në muajt e fundit.

Grafik 12. Kredia për individë në vendet e rajonit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Standardet e kreditimit të individëve në vendet e rajonit shfaqen të shtrënguar në gjysmën e parë të vitit, ndërsa kërkesa për kredi është vlerësuar në rritje. Pritjet për kushtet e kreditimit në këtë rajon kanë mbetur në të njëjtin kah shtrëngues edhe për tremujorin e tretë të vitit, ndërsa pritjet për kërkesën për kredi në këtë periudhë janë vlerësuar gjithashtu në rënie. Rënia e kërkesës duket të jetë materializuar në vlerat aktuale të muajve korrik dhe gusht, të

cilat konfirmojnë ngadalësimin e normave të rritjes së kredisë, si për rajonin e Evropës Qendrore ashtu edhe për vendet e Ballkanit.

Grafik 13. Ecuria e kushteve të kreditimit dhe kërkesës së individëve në Shqipëri dhe në vendet e rajonit



Burimi: Banka e Shqipërisë.